

20161904203

## LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR REVIZION TË INSTRUMENTIT PËR NDIHMË PARAADERUESE (IPA)

### Neni 1

Në Ligjin për revizion të instrumentit për ndihmë paraaderuese (IPA) ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 66/10, 43/14, 154/15 dhe 27/16), neni 1 ndryshon si vijon:

"Me këtë ligj rregullohen lënda për revizion, organizimi dhe kompetencat e Trupit Revizor për revizion të instrumentit për ndihmë paraaderuese (IPA) dhe mënyra e kryerjes së revizionit të implementimit të instrumentit për ndihmë paraaderuese (IPA) dhe të programeve të financuara nga Bashkimi Evropian për të cilat është bartur menaxhimi i Republikës së Maqedonisë."

### Neni 2

Neni 2 ndryshon si vijon:

"Nocionet e caktuara të përdorura në këtë ligj e kanë këtë kuptim:

1. "Instrument për ndihmë paraaderuese" (në tekstin e mëtejme: IPA) është ndihmë paraaderuese financiare të cilin Bashkimi Evropian ua siguron vendeve candidate dhe kandidatëve potencialë për anëtarësim në Bashkimin Evropian;

2. "Marrëveshja Kornizë" është Marrëveshje Kornizë ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit Evropian për rregullat për bashkëpunim lidhur me ndihmën financiare të Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë në suaza të zbatimit të ndihmës sipas Instrumentit për ndihmë paraaderuese (IPA) të ratifikuar me Ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes Kornizë ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit Evropian për rregullat për bashkëpunim lidhur me ndihmën financiare të Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë në suaza të zbatimit të ndihmës sipas Instrumentit për ndihmë paraaderuese (IPA) ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 18/2008) (në tekstin në vijim: "Marrëveshja Kornizë për IPA) dhe Marrëveshjes Kornizë ndërmjet Republikës së Maqedonisë e përfaqësuar nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit Evropian për procedurat për zbatimin e ndihmës financiare nga Bashkimi për Republikën e Maqedonisë në suaza të zbatimit të ndihmës sipas Instrumentit për ndihmë paraaderuese (IPA II), të ratifikuar me Ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes Kornizë ndërmjet Republikës së Maqedonisë të përfaqësuar nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit Evropian për procedurat për zbatimin e ndihmës financiare nga Bashkimi për Republikën e Maqedonisë në suaza të zbatimit të ndihmës sipas Instrumentit për ndihmë paraaderuese (IPA II) ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 99/2015) (në tekstin në vijim: Marrëveshja kornizë për IPA II);

3. "Marrëveshja e sektorit" është Marrëveshje e sektorit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit të bashkësive evropiane për rregullat për bashkëpunim lidhur me ndihmën financiare nga Komisioni Evropian për Republikën e Maqedonisë dhe zbatimin e ndihmës sipas komponentit V (IPARD) nga Instrumenti për ndihmë paraaderuese të ratifikuar me Ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit të bashkësive evropiane për rregullat për bashkëpunim lidhur me ndihmën financiare nga Komisioni Evropian për Republikën e Maqedonisë dhe zbatimi i ndihmës sipas Komponentit V (IPARD) nga instrumenti për ndihme paraaderuese ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 165/2008) (në tekstin në vijim: Marrëveshja e sektorit për IPARD) dhe Marrëveshja e sektorit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit Evropian për vendosjen e dispozitave për menaxhim dhe zbatimin e ndihmës financiare të Bashkimit për Republikën e Maqedonisë sipas Instrumentit për ndihmë paraaderuese në sferën e politikës për "Bujqësi dhe Zhvillim Rural" (IPARD), të ratifikuar me Ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së sektorit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit Evropian vendosjen e

dispozitive për menaxhim dhe zbatimin e ndihmës financiare të Bashkimit për Republikën e Maqedonisë sipas Instrumentit për ndihmë paraaderuese në sferën e politikave për "Bujqësi dhe Zhvillim Rural" (IPARD) ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 38/16) (në tekstin në vijim: Marrëveshja e sektorit për IPARD II);

4 "Trupi revizor për revizion të Instrumentit për ndihmë paraaderuese" (në tekstin e mëtejme: Trupi revizor) është trup për revizion, i themeluar në pajtim me këtë ligj dhe dispozitat nga Marrëveshja Kornizë;

5. "Subjekt i revizionit" është person fizik, tregtar individ dhe person juridik i cili shfrytëzon mjete nga programet e financuara nga Bashkimi Evropian, si dhe struktura dhe organe përgjegjëse në sistemet për menaxhim, zbatim, kontroll, mbikëqyrje, përcjellje, evaluim dhe njoftim për implementimin e programeve të financuar nga Bashkimi Evropian;

6. "Koordinatori nacional për autorizim" është organ në sistemet për menaxhim të decentralizuar dhe indirekt me mjetet nga Instrumenti për ndihmë paraaderuese (IPA), i emëruar nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë përgjegjës për menaxhimin financiar dhe për funksionimin efektiv të sistemeve për menaxhim dhe kontroll me mjetet nga Instrumenti për ndihmë paraaderuese (IPA) në Republikën e Maqedonisë;

7. "ISSAI (International Standards of Supreme Audit Institutions)" janë standarde ndërkombëtare të Institucioneve të Revizorëve Suprem të lëshuar nga ana e Organizatës ndërkombëtare të Institucioneve të Revizorëve Suprem (INTOSAI);

8. „OLAF (European Anti-Fraud Office)“ është Zyrë Evropiane për pengimin e mashtrimit. “.

### Neni 3

Neni 3 ndryshon si vijon:

"(1) Punët e revizionit IPA dhe programet tjera të financuara nga Bashkimi Evropian për të cilat është bartur menaxhimi i Republikës së Maqedonisë i kryen Trupi Revizor.

(2) Trupi revizor është funksionalisht i pavarur nga pjesëmarrësit në sistem që janë përgjegjës për menaxhim, zbatim, kontroll, mbikëqyrje, përcjellje, evaluim dhe njoftim për programe të financuar nga Bashkimi Evropian.

(3) Selia e Trupit Revizor është në Shkup."

### Neni 4

Në nenin 5 pas paragrafit (2) pas pikës 3) shtohet pikë e re 4) si vijon:

"4) të kenë dëshmi për titull të fituar nga sfera e revizionit;"

Pikat 4), 5), 6) dhe 7) bëhen pika 5), 6), 7) dhe 8).

### Neni 5

Në nenin 9 pika 2) ndryshon si vijon:

"i miraton planet e punëve vjetore për revizion dhe strategji për revizion për periudhën prej tre vitesh (në tekstin në vijim: Strategjia revizore trevjeçare)".

Pika 4) ndryshon si vijon:

"i parashtron raportet e revizorit dhe mendimet e revizorit në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes Kornizë dhe Marrëveshjes së Sektorit;"

### Neni 6

Në nenin 15 pika në fund të fjalisë shlyhet dhe shtohen fjalët: "si revizorë të pavarur nga subjektet lëndë e revizorit respektivisht strukturat dhe organet të cilat i implementojnë programet e financuara nga Bashkimi Evropian."

### Neni 7

Në nenin 16 paragrafi (3) pas fjalës revizion fjalët: "të IPA" shlyhet.

#### Neni 8

Në nenin 19 paragrafi (1) ndryshon si vijon:

"Trupi revizor kryen revizione në sistemin menaxhues dhe kontrollues të aktiviteteve, transaksioneve dhe të llogarive vjetore në pajtim me ISSAI dhe me strategjinë revizore trevjeçare."

Në paragrafin (3) pika 1) ndryshon si vijon "revizion sistemor".

Në pikën 2) fjalët: projekte/programe" zëvendësohen me fjalët "transaksione/operacione".

#### Neni 9

Neni 25 ndryshon si vijon:

"(1) Revizioni kryhet në pajtim me plan vjetor të punës për revizion respektivisht strategji revizore trevjeçare ku është përfshirë metodologjia për revizion dhe aktivitetet e planifikuara të revizorit.

(2) Plani vjetor i punës për revizion dorëzohet te Koordinatori Nacional për autorizim dhe te Komisioni Evropian, më së voni deri më 30 shtator në vitin rrjedhës, për periudhën referente prej 1 tetorit të vitit rrjedhës përfundimisht me 30 shtator të vitit të ardhshëm, në pajtim me Marrëveshjen Kornizë për IPA.

(3) Strategjia trevjeçare revizore dorëzohet te Komisioni Evropian si dhe kopje te koordinatori Nacional për autorizim, më së voni deri në fund të nëntorit të vitit rrjedhës për vitin e ardhshëm, në pajtim me Marrëveshjen Kornizë për IPA II."

#### Neni 10

Neni 26 ndryshon si vijon:

"Trupi revizor parashtron raporte dhe mendime në pajtim me Aneksin A pika 7 nga Marrëveshja Kornizë për IPA dhe Aneksin A klauzola 5 nga Marrëveshja kornizë për IPA II dhe Marrëveshja Sektoriale për IPARD dhe Marrëveshja Sektoriale për IPARD II."

#### Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".